

KOMPANIA “PRO & CO GROUP” SH.P.K. VITI



RAPORT

I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR IMPIANTIN E BETONARES

Prishtinë
maj 2023

Numri i projektit		
Investitori :	INVESTITORI: "PRO & CO GROUP" shpk K.Viti Kenan Emini drejtor _____ v.v	
Emërtimi i projektit	Raport I Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Bazën e prodhimit të Betonit	
Lokacioni :	Preoc-Graçanicë	
Hartuesit e Raportit të VNM-s	Menderes Halabaku inxh.dipl.i gjeol. _____	

Përmbajtja

1	Hyrje	5
2	Baza ligjore për hartimin e raportit	6
3	Përshkrimi lokalitetit dhe mjedisit	8
3.1	Pozita gjeografike e lokalitetit	8
3.2	Popullata dhe Vendbanimet	10
3.3	Lidhjet dhe komunikacioni	11
3.4	Relievi	12
3.5	Kushtet klimatike	12
3.6	Hidrogjeologjia	13
3.7	Pedologjia	14
3.8	Natyra dhe biodiversiteti	14
3.9	Bimësia dhe vegjetacioni	15
3.10	Bota shtazore – fauna	15
3.11	Peizazhi	16
3.12	Dukshmëria	16
3.13	Ajri	17
3.14	Uji	17
4.0	Linja teknologjike për procesin e prodhimit të betonit (skema e vendosjes së makinerisë)	19
5.0	Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve të mundshme në mjedis	38
5.1	Ndikimi në Ajër	38
5.2	Ndikimet në tokë	38
5.3	Ndikimet në ujë	39
5.4	Ndikimet në peizazh	39
5.5	Ndikimet në florë dhe faunë	39
5.6	Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	40
5.7	Zhurma	40
5.8	Ndikimet në raste aksidentale mjedisore	41
6.0	Masat e ndërmarra për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve	41
6.1	Masat e ndërmarra për mbrojtjen e ajrit	41
6.2	Masat e ndërmarra për mbrojtjen e tokës	42
6.3	Masat e ndërmarra për mbrojtjen e ujit	43
6.4	Masat e ndërmarra për mbrojtjen nga zhurma	44
6.5	Masat e ndërmarra për mbrojtjen e botës bimëre dhe shtazore	44
6.6	Masat e ndërmarra për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale	45

7.0	Programi i monitorimit	45
8.0	Raportimi	46
9.0	Masat e ndërmarra rehabilituse pas përfundimit të aktivitetëve prodhuese	46
9.1	Objektivat e rikultivimit	47
9.2	Struktura përfundimtare e sipërfaqeve	47
9.3	Rikultivimi teknik	48
9.4	Rikultivimi agroteknik	49
9.5	Rikultivimi biologjik	50
10.0	Monitorimi pas përfundimit të prodhimit	50
11.0	Konkluzion	50

1.Hyrje

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) që ka të bëjë me linjen për prodhimin e betonit në, z.k. "Preoc", Kompania "PRO & CO GROUP" sh.p.k. , ka të bëjë me kërkesën e investitorit për pëlqimin mjedisor. Ky raport është punuar me kërkesën e Kenan Emiri drejtor i Kompanisë "PRO & CO GROUP" SH.P.K.

Qëllimi: Pëlqimi mjedisor do të shërben Kompanisë për aplikim të marrjes së Lejes për Aktivitete të Veçanta në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (**KPMM**) për vendosjen e linjës për prodhimin e betonit. Ky dokument është i rëndësishëm së veçant dhe i domosdoshëm për vazhdimin e procedurës për marrjen së lejes në KPMM.

Në raport do të bëhet një analizë e ndikimit në mjedis të të gjitha aktiviteteve për vendosjen e linjës përprodhimin e betonit. Kjo analizë ka të bëjë me ndërmarrjen e masave të domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokalitetin ku do të zhvillohen këto aktivitete të lartë cekura.

Duke pasur parasysh karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin ku do të bëhet prodhimi i betonit si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse në një anë dhe karakteristikat inxhiniero-teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, kurse nga ana tjetër bëhet hartimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis ku do të përkufizohen të gjitha ndikimet tjera që mundë të shkaktohen në relacionin prodhim-aktivitete tjera dhe mjedis.

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale si dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme që do të merren për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative. Me rastin e hartimit të raportit janë marr për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvoglimin e ndikimeve gjatë realizimit të procesit teknologjik për prodhimet e betonit.

2. Baza Ligjore për hartimin e raportit

Legjislacioni në lidhje me ruajtjen e mjedisit është në përputhje me normativat evropiane të mbrojtjes së tij, ndonëse cilësia mjedisore është ende në parametra mjaft të ulët. Ligji i parë për mbrojtjen e mjedisit daton ne vitin 2003, tani i hartuar Ligji i ri për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, në të cilin pos tjerash potencohet se të gjitha veprimtaritë e personave fizik dhe ligjor, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari të reja dhe kanë ndikime të theksuara negative në mjedis, do të jenë temë e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis – VNM është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 i cili përcakton te gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit apo mënjanimit të efekteve negative në mjedis në kohën e duhur.

Ligjet më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e VNM-së për projektin për prodhimin e betonit janë si më poshtë:

◆ Ligjet

- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. **08/L-025**
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102

Udhëzimet Administrative

- **Udhëzimi administrativ Nr.04/2022 për Lejen Mjedisore**
- Udhëzimit Administrativ Nr. [07/2021](#) mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes
- Udhëzimi administrativ për administrimin e mbeturinave të rrezikshme (06/2008)
- Udhëzimi administrativ Nr. 20/2012 për export, import dhe transit të mbeturinave
- Udhëzimi administrativ kompetencat e zotëruesit dhe operatorit për trajtimin e mbeturinave (08/2 Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për Pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme
- Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për metodologjinë e zvoglimit të rrezikut nga aksidentet kimike dhe masat për eliminimin e pasojave.
- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës.
- Udhëzimi administrativ për menaxhimin e deponive të mbeturinave(15/2012)
- Udhëzimi administrativ.Nr. 02/2022 përkushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujrave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.

Gjatë hartimit të raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis përpos vizitës që i është bërë lokalitetit, konsultimeve me pronarin dhe ekspertët që udhëheqin procesin për vendosjen e linjës për prodhimine betonit, janë shfrytëzuar edhe:


- Projekti Teknologjik i bazës së betonit
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit
- Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme
- Plani i situacionit
- Kopja e planit të ngastrës
- Harta e rajonit të gjërë

Krahas parashikimeve themelore nga regullivat ligjore të cekura më lartë për nevoja të hartimit të raportit të VNM-s janë shfrytëzuar edhe regullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi. Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshënuar, për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse për mjedis si që është direktiva e VNM-s (85/337/EEC)


3.PËRSHKRIMI I LOKALITETIT DHE MJEDISIT

3.1. Pozita gjeografike e lokalitetit


Zona kadastrale "Preoc", Nr. I ngastrës 599-8 me sipërfaqe $S = 6013 \text{ m}^2$, pjesa e ngastrës në fjalë është pasuri private e Kenan Eminit drejtor i kompanisë "PRO & CO GROUP" SH.P.K. Ngastara është e kufizuar me koodrinatat:



Harta nga Gjeoportali ku do te vendoset Betonara e paraqitur - Pozita e Betonares



Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokalitetit janë bazë themelore për hartimin e raportit. Hulumtimi dhe vlerësimi është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren. Për tu definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për tu krijuar bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme në kuadër të gjendjes, janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike, hidrografike dhe meteorologjike. Bazuar në të dhënat e mësipërme, del se impianti i bazës për prodhimin e betonit do të vendoset në lokalitetin “Preoc” afër rrugës magjistrale që lidhë Ferizajin-Prishtinën në një distance rreth **550 m(paraqitur në ortofoto)** kurse nga autoudha ka një distance në vijë ajrore rreth 410 m por çasja nuk është e mundur për shkak të specifikave të njohura të autoudhës.



Vija reale e cila tregon rrugën nga betonara në rrugën magjistrale Prishtinë-Ferizaj(800 m)

Ky impiant bazuar në vrojtimet e terrenit del se posedon kushte optimale ekologjike, gjeologjike, hidrografike për zhvillimin e veprimtarisë së lartëshënuar për vendosjen e impiantit për prodhimin e betonit. Siq shihet në orto foto, ky lokalitet është i zhveshur me një bimësi të ulët, tokë bujqësore rreth së cilës pronë zhvillohen aktivitete të njejtë (Baza e asfaltit dhe betonjera e kompanisë (SALLAHU), pastaj betonjera e kompanisë “ARIANI COMPANY”. Shiqar nga kjo perspective e objekteve afariste në këtë zone mundë të konsiderojmë se ky lokacion po merr formën e një zone industriale. Në kopjen e planit që do tia bashkangjesim këtijë raporti do ti shënojmë edhe koordinatat e pikave kufizuese. Në këtë lokalitet është e rregulluar infrastruktura rrugore të cilën do ta shfrytëzojë kompania “PRO & CO GROUP” SH.P.K.

3.2 Popullata dhe Vendbanime

Komuna e Graçanicës është krijuar në vitin 2010 nga zgjedhjet lokale të Kosovës, të cilat u mbajtën në fund të vitit 2009. Ajo është një nga shtatë

komunat e themeluara në atë kohë dhe është formuar nga vendbanimet e komunave të [Prishtinës](#), [Lipjanit](#) dhe [Fushë Kosovës](#). Komuna e Graçanicës ndodhet në peizazhin qendror të Kosovës, të njohur si [Fusha e Kosovës](#). Në veri kufizohet me komunat e [Prishtinës](#) dhe [Fushë Kosovës](#) dhe në jug me [komunën e Lipjanit](#). Ka gjithsej 16 fshatra në komunë. Zona ka një sipërfaqe prej 131 km². Së bashku me komunat e Prishtinës, [Podujevës](#), [Drenasit](#), Lipjanit, [Kastriotit](#), Artanës dhe Fushë Kosovës, formon [Rajonin e Prishtinës](#)


Regjistrimi i vitit 2011 tregoi se komuna e Graçanicës kishte një popullsi prej 10.675, prej të cilëve 7.209 ishin [serbë](#), 2,474 si [shqiptarë](#), 852 si [romë](#), [ashkali](#) dhe egjiptianë të Ballkanit, 22 si [goranë](#), 15 si turq dhe 15 si [boshnjakë](#). 45 i përkisnin grupeve të tjera etnike dhe nga 43 persona nuk kishin përgjigje në lidhje me origjinën etnike.

3.3 Lidhjet dhe komunikacioni

Përshkak të pozitës gjeografike të lokacionit lidhjet dhe komunikacioni janë të rëndësishme në aksin rrugor Prishtinë Ferizaj -Lipjan

Prishtina për shkak të statusit të kryeqendrës është nyje e të gjitha lidhjeve të komunikacionit rrugorë dhe ajrorë. Neper Territorin e Prishtiëns kalon një pjesë e Autostrades R7 Prishtinë-Prizren-Durrës. Ajo posedon dalje në jug në Fushë Kosovë dhe në veri fshatin Mazgit. Gjithashtu kjo autostradë lidhet me Autostradën R6 në drejtim të kufirit me Maqedoninë, ndertimi i së cilës

ka filluar në vitin 2014 dhe ka perfunduar në vitin 2018, dhe lidhë Prishtinën me Shkupin përmes Ferizajt dhe Hanit të Elezit.



3.4 Relievi

Shiqvar në aspektin morfologjik, rajoni i gjërë ku do të vendoset baza për prodhimin e betonit është pothuajse i rrafshët me një ngritje të butë relievit nga ana jugore, Lartësia mbidetare në lokacionin ku do të vendoset impianti sillet rreth 652 m. Nuk shquhet për rrjedhat e shumta ujore, kurse niveli i ujrave nëntokësore varion mvarësisht nga lokacioni në të cilin kërkohen këto ujra.

3.5. Kushtet klimatike

Klima e kësaj treve sipas pozitës së saj gjeografike, lartësisë mbidetare ndër më të ultat në Kosovë dhe sipas hulumtimeve meteorologjike karakterizohet

si trevë me temperature më të lartë në vendin tone duke u identifikuar me këto karakteristika siç janë: reshjet dhe temperaturat mesatare mujore dhe vjetore, përbëjnë një klimë kontinentale.

Sa i përket reshjeve dhe temperaturave, pranvera dhe vjeshta karakterizohen përafërsisht me klimë të njëjtë. Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal. Temperatura mesatare sillet prej 11-12°C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 11,5°C. Temperaturat më të larta janë në muajin qershor 35,6°C, ndërsa në korrik 32,4°C dhe në gusht 31,1°C. Temperaturat maksimale mesatare vjetore janë 22,5°C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej (-1,7)-(-3,4°C).

Regjimi i reshjeve në komunën e Prishtinës dhe Graçanicës ka karakterin e klimës kontinentale.. Shuma e përgjithshme e reshjeve sillet nga 498 mm deri në 677 mm. Vlera mesatare vjetore e lagështisë relative është 77.8%. Muaji më i thatë është gushti 66.2%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84.2 %.

Në lokalitetin ku planifikohet të vendoset impianti për seperimin erërës dhe zhavorrit më së shumti janë të përfaqësuara erërat veriore si karakteristikë e erërave në vendin tonë. Me intensitet më të madh të shpejtësisë paraqiten erërat veriore, veri perëndimore si dhe erërat perëndimore, kurse ato jugore janë me intensitet më të vogël. Në komunën e Prishtinës dhe Graçanicës me një lartësi mjaft të butë, erërat më të shpeshta janë ato veriore me 26‰ dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me 27‰, kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 2.2 m/sek.

3.6. Hidrogjeologjia

Karakteristikat hidrogjeologjike janë të thjeshta . Morfologjia, ndërtimi gjeologjik dhe tektonika janë faktorë dominant të cilët definojnë lëvizjen e

ujrave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore. Në afërsi të lokacionit ku do të vendoset linja për baza për prodhimin e betonit , nuk ekzistojnë burime të ujit, por ka sasi të bollshme të ujit nëntokësorë gjatë gjithë vitit kalendarik. Ujërat sipërfaqësore paraqiten vetën në sezonën e reshjeve atmosferike të cilat drenohen në kanalet natyrale. Thellësia e nivelit të ujrave nëntokësore është e rreth 7 m në sezonën e verës kurse në dimër ai nivel ngritet në 5m në sipërfaqe. Ky ndryshim jo shumë i theksuar i nivelit të ujrave është përshkak se kjo zonë është e ngopur nga rrjedha e lumit Sitnica, kjo është konstatuar nga shpuarja e një pusi me diametër Ø160mm ,thellësi 20 m për nevojat e kompanisë.

3.7 Pedologjia

Në aspektin pedologjik ,në lokacionin ku do të vendoset linja për prodhimin e betonit, në një distance vërehen edhe toka të kultivuara me të lashta bujqësore pasi që në vendin ku është i vendosur impianti relievi është i rrafshët. Gjithashtu në afërsi të impiantit shihet një bimësi mirë e zhvilluar përshkak të tokave ranore të cilat për tu kultivuar kërkojnë ujë të vazhdueshëm për ujitje. Në lokacionit ku do të vendoset linja për prodhimin e betonit toka ka ngjyrë kafe e aty këtu të hapur , lagështinë e merr nga të reshurat atmosferike dhe ujrata nëntokësore . Kjo zonë nuk paraqet ndonjë pengesë për zhvillimin e këtij aktiviteti nga ana e operatorit.

3.8 Natyra dhe biodiversiteti

Në bazë të të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë terren kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të

mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është ndonjë zonë apo teritor e që është potencial të futet nën mbrojtje.

3.9. Bimësia dhe Vegjetacioni

Në lokacionit ku do të vendoset linja për prodhimin e betonit, sipërfaqja është e mbuluar pjesërisht nga bari i cili ka mbirë vet edhe ate në një masë të vogël sepse pjesa më e madhe e këtijë lokaliteti është e zbuluar që janë karakteristike e këtijë tereni.

Kemi të bëjmë me një bimësi si të cilat i përshtaten kushteve të jetës në këtë lokalitet. Lokaliteti përbëhet nga një terren i rrafshët, kurse jashtë kufinjëve të ngastrës konfiguracioni i terrenit ndryshon dhe merr një pjerrtësi më të butë poashtu edhe vegjetacioni fillon të jetë më i dendur përshkak të tokave të punuara.

Me një fjalë ngastra ku duhet të shfrytëzohet mundë të paraqet një lokacion me vlerë të theksuar ekonomike për tu përdorur si tokë bujqësore. Poashtu ka vlerë edhe si kullosë për bagëtinë.

3.10 Bota shtazore-Fauna

Problematika e gjendjes egzistuese të llojeve shtazore nuk është e studjuar në masë mjaftueshme për të sjellë përfundime meritore në këtë domen.

Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit të Graqanicës, e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në këtë zonë jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, , iriqi etj. Ndërsa prej shpezëve janë karakteristike: bilbilat, thëllënza e fushës, sorrat etj.

3.11. Peisazhi

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin prodhim i betonit –mjedisi.

Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive .

Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

Projekti i lartë shënuar i lokacionit ku do të vendoset linja për prodhimin e betonit nuk ka ndonjë ndikim negativ të theksuar në prishjen e peisazhit në lokalitetin e analizuar pasi që kriteret e ndërtimit të bazës së seperacionit kanë kuptim inxhinjerik , dhe vetë baza do ti plotëson ISO standardet .

3.12. Dukshmëria

Shikuar nga relievi ku kryhen punët e prodhimit, dukshmëria është mjaftë e lartë e posaqërishtë kah ana përrëndimore e cila mundë të mbërrijë gjer në 7 km, sidomos nga vendi ku ndodhet lokacionit ku do të vendoset linja për prodhimin e betonit .


Ky rajon është i mbuluar pjesërisht nga mjegullat vetëm në sezonën e pranverës dhe në vjeshtë.

3.13. Ajri

Nga vet konfiguracioni i terrenit tipi fushorë dhe prezenca e florës, mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit në këtë rajon është në nivel të lakmueshëm. Dhe nuk ka ndonjë shkak që do të ndikonte në ndotjen e ajrit


3.14. Uji

Në këtë lokalitet, respektivisht ngastrën ku do të bëhet vendosja e impiantit për prodhimin e betonit, nuk ka burim të ujërave sipërfaqësore. Këtu edhe ujërat kur kemi të reshura atmosferike nuk vërehen sepse është bërë tharja (Drenazhimi) I sipërfaqes sipas nevojave të kompanisë.



Nga kjo hartë topografike shihet se në afërsi të impiantit nuk ka rrjedha ujore por ato janë në distance mbi 4 km (L. Sitnica dhe L I Lipjanit)

Linja teknologjike për procesin e prodhimit të betonit (skema e vendosjes së makinerisë), prodhim Turk tipi ELKON



4.0 Përshkrimi i proçesit teknologjik(betonjera)

Pjesa e përgjithshme

Përzirëset për beton

Procesi teknologjik për prodhimin e betonit të freskët e përcaktonë konstruksionin e pajisjes makinerike respektivisht stabilimenteve nga aspekti i shpejtësisë së përzierjes së masës, kapacitetit të përzierjes si dhe mundësin e përzierjes nga aspekti i madhësisë së fraksioneve të agregateve. Gjatë përzierjes së përbërësve të betonit duhet mbizotëruar forcat e brendshme të cilat i lidhe grimcat e tyre, pastaj duhet mbizotëruar rezistencat brenda kokërrzave të agregatit si dhe forcën e gravitetit të përzierjes së përgjithshme me rastin e rrotullimit të saj respektivisht ngritjes në operationet e përzierjes.

Përzierja me ramje të lirë e cila kryesisht zgjat shumë (deri rreth 4 minuta), zakonisht përdorët për betonet kokërrmëdha me plasticitet të vogël pa kufizim të madhësisë së kokërrzave respektivisht me këtë mënyrë kryesisht përzihen betonet me kokërrëza të mëdha.

Përzierja e detyrueshme nëpërmjet lopatave posaçërisht të konstruktura tek të cilat koha e përzierjes është më e shkurt (rreth 1 minutë) megjithatë nuk është e zbatueshme për betonet me kokërrëza të mëdha respektivisht zbatohet për betonet e zakonshme “me fraksion” deri 32 mm ose për betonet me kokërrëza të mëdha me pjesëmarrje të vogël të fraksionit të agregatit deri në 45 mm respektivisht më së shumti deri në 63 mm nëse përzihet në mënyrë të detyrueshme pjesërisht kombinohet me përzierje me ramje të lirë

Përzirëset për beton kryesisht punojnë me veprim diskontinual respektivisht në cikle edhe pse zbatohen gjithashtu disa lloje të përzierëseve kontinuale për beton ku mundësohet lloji dhe mënyra e realizimit të punëve tek mënyra ciklike e

prodhimit të betonit të freskët. Sasia e “dozimit” të përbërëseve të posaçëm përcaktohet kryesisht në masë (me peshore). Të përbërja optimale sipas “recepturës së rekomanduar” masa futët në tamburin e përzierëses për përzierje.

Përzieret ciklike për beton ndahen në dy grupe kryesore përzierëset: gravitacionele dhe të detyruara për beton. Duhet përmendur që nga aspekti i llojeve, i madhësive, i mënyrës së mbushjes si dhe pjesëve tjera të cilat “shërbejnë” për përzierje para dhe pas dallojmë këto pajisje për prodhimin e betonit të freskët:

- Të vogla bartëse (sipas kapacitetit), gjysmë të lëvizshme ose të lëvizshme (të tërhequra), kryesisht përzierëse gravitacione me mbushje me dorë të tamburit të përzierëses.

Mesatarisht të mëdha vetëlëvizëse gjithashtu kryesisht gravitacione ose përzierëse kërmillore në bazament të lëvizshme në rrotë (kamionë të vegjël).

- Përzirëse të vogla të lëvizshme në kamionë me të mëdhenj me përzierëse gravitacione,

- Bazat për beton (betonjerkat) me koncepte dhe konstrukcion të ndryshëm nga aspekti i përzierjes, kapacitetit dhe lëvizshmërisë me përzierëse gravitacione ose të detyruar.

Linja teknologjike për procesin e prodhimit

Infrastruktura dhe objekti i Bazës së betonit është me dimensione të parapara për mbajtjen e ngarkesave punuese. Pjesa e nënstrukturës është e ngjeshur për vendosjen pajisjet makinerive siç janë: për teknologjinë e prodhimit betonit dhe produkteve nga betoni është zgjedhur impianti i tipit **“ELKON”prodhim Turk**.Pajimet themelore (makinat, stabilimentet, pajimet dhe pjesët tjera përcjellëse) të vijës teknologjike përmbajnë:

1. Bunkerët e agregatit $4 \times 30 = 120 \text{ [m}^3\text{]}$ se bashku me pistonat dhe pajisjet përcjellëse, tipi (ELKON)
2. Transportieri horizontal mbledhës $B = 1000 \text{ [mm]}$ – Dozatori,
3. Përzierësja e betonit – Mikseri ($V = 3.0 \text{ [m}^3\text{]}$),
4. Siloet e çimentos (me vëllim $V = 100 \text{ [t]}$),
5. Transportierët kërmillor nga siloet e çimentos ($2 \times n \text{ 280 [mm]}$),
6. Kompresori i ajrit të komprimuar (5.5 [kW]),
7. Pompa e aditivit të çimentos,
8. Pusi dhe pompa e ujit me pajisje përcjellëse,
9. Kabina komanduese e bazës së betonit,
10. Dizel gjeneratori m trefazore 380 [kVA] ,
11. Transformatori YZ5 250 [kVA] , $0.4/10 \text{ [kV]}$.

Kapaciteti prodhues i bazës së betonit është $Q = 80 \text{ [m}^3\text{/h]}$, ku për realizimin e kësaj prodhimtarie është e nevojshme të zërthehet në kohën për punë


ndihmëse dhe punë përgatitore sipas treguesve real dhe praktik që deri me tani janë arritur për një ndërrim i cili merret si kohe efektive 7 [h] ose koeficienti i shfrytëzimit kohor është

$$k_t = (8-1)/8 = 0.875$$

Tab. Kapacitetet prodhuese

Nr	Njesia kohore	Kapaciteti (m^3)
1	Kapaciteti orar	80
2	Dit me një ndërrim	560
3	Dita me një ndërrim të gjatë	840
4	5 muaj (153 dit me 1 ndërrim)	85680
5	3 muaj (92 dit me 1.5 ndërrim)	77280
6	viti	162960

ALGORITMI I PROCESIT TEKNOLOGJIK PËR BAZEN E BETONIT “PROCO GROUP” sh.p.k
VITI



Algoritmi i prodhimit betonit

Kapaciteti maksimal për prodhimin e betonit të freskët është ~ **135 [m³/h]** dhe fillon me përgatitjen e materialeve si rëra dhe zhavori, çimento, uji dhe aditivët (nëse është i nevojshëm përdorimi i tyre). Prodhimi i betonit në betonier fillon me përgatitjen e lëndëve të para: agregatit (fraksioneve të gurit apo fraksioneve të rërës), çimentos dhe ujit. Procesi teknologjik i prodhimit të betonit të freskët ka këtë rrjedhë:

Deponimi i agregatit

Agregati i granulateve të ndryshme deponohet në pjesën pasme të bazës së betonit me kamionë dhe i njëjti ngarkohet me lugë ngarkuese. Proces tjetër paraqitet mbushja e silosi me çimento të tipit të caktuar, mbushja bëhet me anë të auto-cisternave me proces pneumatik.

Bunkerët e Agregatit

Procesi teknologjik për prodhimin e betonit, fillon me mbushjen e benkerve pranuse me rërë apo gur me granulacione të ndryshme në varësi të markës së betonit që dëshirohet të prodhohet, siloset pranues me fraksione të gurit ose rërës mbushen me anë të lugës ngarkuese nga depoja e fraksioneve të agregatit, katër siloset me fraksione të gurit ose rërës, janë të ndara njëra prej tjetrës me mure të pllakave të çelikut (Poz. 01), $30 \times 4 = 120$ [m³].

Përgatitja e agregatit

Nga bunkerët e agregatit (Poz. 01) me vëllim $V = 30 + 30 + 30 + 30 = 120$ [m³] në dozatorin bëhet zbrazja e agregatit përmes mbyllëseve që komandohen përmes pistonave pneumatik. Nga bunkerët e agregatit (Poz. 01), agregati përmes transportierit horizontal mbledhës – Dozatorit (Poz. 02) bartet në Skipin e

agregatit (Poz. 03) ku me pas agregatin e gatshëm e dorëzon në përzierësen e Betonit – Mikserit (Poz. 04). Hapja e fortinave të dozatorëve të caktuar, është e programuar në varësi nga granulati i agregatit që kërkohet për tipin dhe markën e betonit. Për çdo tip apo markë betoni, procesi teknologjik është i programuar dhe menaxhohet nga kabina komandues (Poz. 10). Projekti i këtij sistemi, me lëshuarje në punë të tërë linjës teknologjike mundëson plotësisht **menaxhimin automatik** të tërë procesit teknologjik të prodhimit të betonit. Përbërësit tjerë të konglomeratit për beton si çimento që vije nga siloset e çimentos (Poz. 05) nëpërmjet transportierëve kërmillor (Poz. 06) hidhët në dozatorin e çimentos dhe po i njëjti, në masën e caktuar sipas parametrave bie në mikser volumi i të cilit është **2 [m³]**. Agregati nga të katër bunkerët (Poz. 01) në dalje të cilëve ndodhën dozuesit elektro - pneumatik të cilët me dhënien e komandës nga tabela komanduese hapen dhe mbyllen në mënyrë automatike pasi ta lëshojnë sasinë e caktuar të agregatit në shiritin transportues që ndodhet në siloset e agregatit i cili i transporton granulacionet (fraksionet) e agregatit gjatë skipin - enën e cila nevojitet për bartjen e fraksioneve të agregatit gjatë mikser (përzierëse) për prodhimin e betonit. Në dozuesit e fraksioneve më të imta janë të vendosur vibruesit me qëllim të rrjedhjes së fraksioneve sa më lehtë në enën e agregatit.

Hinka pranuse

Nëpërmjet transporterit horizontal furnizues – Dozatorit (Poz. 02) respektivisht shiritit transportues të agregatit (Poz. 03), agregati i përgatitur transportohet dhe hidhet në përzierësen e betonit – Mikser (Poz. 04). **Mbushja e siloseve**

Mbushja e silosit (rezervuarit) të çimentos (Poz. 05) bëhet me auto-cisternë me ndihmën e pajisjeve pneumatike. Mbi siloset, janë të vendosur euro-filtrat si dhe tubat pneumatik të cilët veprojnë tek siloset. Euro-filtrat janë të prodhimit italian dhe shërbejnë për pastrimin e ajrit nga pluhuri që del nga siloset gjatë mbushjes

së tyre nga auto-cisterna dhe punës kontinuale të tyre për furnizimin e përzierëses me çimento. Të ngarkuarit e silosit (Poz. 05), gjegjësisht deponimi i çimentos bëhet me hapjen e valvualve përkatëse (V1, V2) dhe përmes tubave (T1, T2), me shtytje pneumatike (Sh1, Sh2) dhe hedhet në brendi të silosit. Funkcioni i mbushjes dhe zbrazjes së silosit është i kontrolluar përmes niveluesit (N1, N2) me sinjalizim si dhe sistem alarmi.

Transporti i çimentos (kërmillori) deri në përzierëse

Transporti i çimentos nga silosat (Poz. 05) e deri në përzierësen e betonit - mikser (Poz. 04) behët përmes dy kërmilloreve me gjatësi 7.5 [m] (Poz. 06). Dozimi i çimentos në përzierës bëhet nëpërmes transportuesit kërmillor nga silosi. Çimentoja me ramje të lirë bien në transportuesit të vendosur nën silos, me pas nëpërmjet transportuesit kërmillor dozohet në enën e peshojës për çimento. Zbrazja e enës së peshojës kryhet në mënyrë të programuar dhe atë në kohën e dozimit të agregatit në mikser (përzierëse). Ashtu që zbrazja e pajisjes për dozim të çimentos në mikser (përzierës) fillon automatikisht në momentin e fillimit të dozimit të agregatit nga ena në mikser (përzierës), apo disa sekonda më vonë. Gjatë kohës së zbrazjes së enës së peshojës me çimento duhet të lëshohet vibruesi, kur procesi kryhet në mënyrë manuele, kur procesi kryhet në mënyrë automatike vibruesi lëshohet në mënyrë automatike.

Përcaktimi i sasisë së çimentos

Përcaktimi i sasisë së çimentos bëhet me anën e peshores matëse në vartësi nga lloji i recepturës së betonit të freskët

Uji dhe rezervuarët e ujit të deponuar- Uji për furnizim të përzierëses - mikserit sigurohet nga pusi (Poz. 09) i hapura në këtë bazë të betonit dhe me pas uji akumulohet në rezervuarët e ujit 3000 [litra] respektivisht përmes pompës dhe

matësit të rrjedhjes hidhet në mikser. Dozimi i ujit në përzierëse si lëndë e parë bazë për përfitimin e betonit bëhet me dozimin e programuar nga pompa për furnizim me ujë ku meqe raste ky proces kryhet gjithashtu në mënyrë automatike me fillimin e dozimit të çimentos. Pas dozimit të sasisë së caktuar të ujit, valvula dozuese automatikisht mbyllet. Nëse janë përmbushë kushtet e procesit për punë automatike (sasia e nevojshme e agregatit në fortin, shtypja e ujit duhet të jetë min. 3 [at] dhe sasia e nevojshme e çimentos), sasia e prodhuar e betonit për një cikël është 2 [m³], zgjatja e një cikli është përafërsisht 45 [s] në varshmëri të llojit të betonit. Gjatë kryerjes së procesit në mënyrë manuele koha e zgjatjes së ciklit varët nga aftësia e punëtorit që operon me pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.

Pompat për aditivët e betonit Që të zhvillohet procesi i përfitimit të betonit si komponentë lidhëse mbetet ardhja apo dozimi i ujit dhe komponentëve tjerë si aditivët të cilat shtohen në varësi nga tipi i betonit dhe kushteve tjerë që kërkohen në implementimin e betonit (Poz. 08). Sasia e ujit bëhet po ashtu me dozim nga dozatori dhe pompa për furnizim me ujë.

Kompresori për ajrin e komprimuar Procesi i mbylljes së dozatorëve të agregatit, dhe pajisjeve tjerë përcjellëse në Bazën e Betonit, realizohet përmes pistonave pneumatike që furnizohen me ajër të komprimuar nga kompresori pistonik (Poz. 07).

Prodhimi i gatshëm (Betonit freskët)

Prodhimi i gatshëm (betoni i freskët) nëpërmjet hinkës zbrazet nga fundi i përzierëses në auto-përzierëset dhe me pas bartet te klienti.

Që të zhvillohet procesi i përfitimit të betonit si komponentë lidhëse mbetet ardhja apo dozimi i ujit dhe komponentëve tjerë si aditivët të cilat shtohen në varësi nga

tipi i betonit dhe kushteve tjera që kërkohen në implementimin e betonit. Sasia e ujit bëhet po ashtu me dozim nga dozatori dhe pompa për furnizim me ujë.

Riciklimi i betonit

Me qëllim të ruajtjes së mjedisit dhe deponimit të betonit të forcuar, ndërmarrja “PRO & CO GROUP“ sh.p.k është në proces të realizimit të sistemit për riciklimin e betonit i cili shfaqet gjatë procesit të larjes së mikserit të betonuarës, auto mikserëve, pompës së betonit dhe pajisjeve tjera.

Ky sistem i riciklimit mundëson që të mos kemi deponim të betonit të ngurtësuar dhe mbrojtje të mirë të mjedisit. Kjo do të ishte një përshkrim i shkurtër i lëvizjes së materialeve në skemën teknologjike për prodhimin e betonit. Teknologjia e prodhimit të betonit kërkon që, gjatë ngarkimit të mikserit me agregate, së pari nga fortinat lëshohet rëra me granulim më të vogël, pastaj çimento dhe më pastaj zhavorri. Se çfarë përzierje gjegjësisht konglomerati do të fitohet, mund të themi se komponentët futen në këto raporte të dhëna në përqindje:

agregat 85%, çimento 14% dhe mbetja ujë si dhe aditivët që shtohen në përmasa të caktuara.


Ndër aditivët, që jepen në varshmeri të kualitetit, është aditivi kur kemi të bëjmë me sanimin e betonit tek i cili kërkohet të shpejtuarit e kohës së ngurtësimit apo fortësisë e që në veçanti është si imperativ për prodhimin e betonit dhe implementimit të tij gjatë kohës së dimrit dhe aplikimit të tij tek konstruksionet e ndryshme të betonit. Para se të lëshohen pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, duhet të kryhen këto veprime:

- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e agregatit në silos,
- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e çimentos dhe duhet hapur vetëm ventilin e silosit nga i cili dëshirojmë të marrim çimento,
- Duhet të sigurohet sasia e nevojshme e ujit,
- Duhet caktuar recepturën për kualitetin e betonit të cilin dëshirojmë ta prodhojmë,
- Të caktohet zgjatja e kohës së ciklit të prodhimit të betonit duke u bazuar në recepturën e caktuar.

Pajimet mund të funksionojnë në mënyrë automatike me dozim të programuar dhe në mënyrë manuale. Menaxhimi i procesit teknologjik i prodhimit të betonit, kryhet nga pulti komandues i automatizuar i vendosur në dhomën (hapësirën) të caktuar për te. Modulet hyrëse drejtpërdrejt pranojnë sinjalet nga dozatorët dhe peshojat, nëpërmjet sondave për të gjithë komponentët e procesit të prodhimit. Modulet digjitale dalëse shërbejnë për menaxhimin e ventileve elektromagnetikë, motorëve si dhe llampave sinjalizuese. Menaxhimi i tërë procesit të prodhimit bëhet edhe përmes disa monitorëve të vendosur në panelin e komandimit, përmes këtij paneli operatorit i mundësohet të bëjë mbikëqyrjen e tërë procesit dhe recepturat për prodhimin e betonit, me këtë mundësohet matja e lehtë e komponentëve të agregatit, bitumenit dhe komponentëve tjerë shtesë. Për të arritur cilësinë e duhur të betonit bëhet sitja e çimentos me sita standarde dhe përcaktohet kohëlidhja e sajë. Përpos komponentëve të lartcekura për të arritur veçori specifike të betonit, duhet shtuar Aditivët. Në sezonin e dimrit dhe për konstruksione të veçanta shtohen aditivë të cilët e shpejtojnë kohën e ngurtësimit. Aditivi kryesisht shtohet me ujë, ose drejtë për drejt në mikser. Dozimi i aditivit kryesisht shtohet 2-4% të masës së çimentos. Për realizimin e procesit

teknologjik për prodhimin e betonit, me energji elektrike furnizohet nga rrjeti elektrik nëpërmjet trafos të ndërtuar nga kompania, gjithashtu ne mungesë të energjisë elektrike kompania posedon gjeneratorin për realizimin e procesit teknologjik. Përpos pajisjeve të lartë cekura për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit dhe për bartjen e tij gjer te harxhuesi (konsumatori), kompania do të disponoj edhe këtë mekanizëm: disa auto mikserë për bartjen e çimentos,pompa të betonit (90 [m³/orë]), kamiona për bartjen e fraksioneve të agregatit dhe lugë ngarkuese, pirunjerë, etj.

Siperfaqeja e tersishme e nevojshme per vendosjen e stabilimenteve te perpunimit betonit per bazen „PRO & CO GROUP”sh.p.k e cila eshte ne nivelin+550.



Permasat e platoes se perpunimit betonit

Siperfaqeja e platos se vendosjes se stabilimenteve

$$70 \times 30 = 2100 \text{ [m}^2\text{]}$$

Kurse dimensionet e hapsires per manevrim te pajisjeve te ngarkimit dhe transportit jan nevojshme edhe

$$581.58+550=1131.58[m^2]$$

Andaj per pune normale te procesit te perifimit betonit nga fraksionet e shkembive karbonatik ne bazen e betonit prone e kompanies „PRO & CO GROUP” shpk. Do te pervetsohet siperfaqeja 3231 [m²] (0.3231 ha) qe eshte ekuaivalente me dimensionet e platoes 92X35[m].

Përshkrimi i shkurtër i linjës me operacionet teknologjike- Transportieri horizontal mbledhësi – Dozatori

Transporteri horizontal mbledhës - Dozatori me shirit gome bartë agregatin e peshuar në peshoren digjitale dhe vihet në lëvizje përmes energjisë elektrike.



Fig.1 Bunkeri pranus per agragate dhe dozatori

Karakteristikat teknike të transportierit:

Gjerësia e shiritit:	1200mm
Gjatësia e transporterit:	$L = 22600$ [mm]
Këndi i pjerrtësisë së transporterit:	$\alpha = 25$ [°]
Shpejtësia	$v = 1.0$ [m/min]



.2. Shiriti i pjerrt transportues

Pasi është e njohur lartësia e transporterit $H=11\text{m}$ dhe gjatësia e transporterit $L=22,6\text{ m}$, këndi i vërtet i pjerrtësisë së transporterit caktohet:

$$\alpha_p = \arcsin (H/L)$$

$$\alpha_p = 25^\circ$$

Në bazë të kësaj mund të konkludohet se këndi vërtet i pjertësisë së transporterit α_p është i barabartë me këndin e lejuar maksimal i pjertësisë së transporterit $\alpha_{p, lej.}$, prandaj dhe plotësohet kushti që transporti i materialit të kryhet pa rrëshqitje të materialit pargjat transporterit nga lartë poshtë.

Transporti kermillor Dy (2) transportier kermillor të çimentos kanë diametrin $\varnothing 273$ mm dhe gjatësia e tyre është $L_1 = 10000$ [mm] dhe $L_2 = 10000$ [mm]. Sistemit pneumatik i rregullimit të çimentos është me dy injektor, të cilat automatikisht aktivizohen nga çdo kërkesë për deponimin, e cila mundëson rënien e qetë të materialit brenda transporterit kermillor. Fuqia e el. 11kW, kapaciteti 11 t/h. Transporterët kanë system lybrifikimi qendror sipas sistemit ELKON.



Përzierësja e betonit – Mikseri Mikseri ka kapacitet prodhues prej 150 [m³/h]. Mikseri i ka të instaluar dy elektro motor elektrik me fuqi nga 55 [kW]. Kapaciteti teorik i mikserit është 3 m³ beton për 60 s.



Kompresori i ajrit të komprimuar

Ajri i kompresur merret nga linja qendrore dhe rezervuari i ajrit të komprimuar me vëllim prej 1023l/min kapaciteti I rezervoarit 500l. Sistemi i ajrit të komprimuar përbëhet nga kompresori, tharësi i lagështisë, lubrifikimi qendror, rregullatori i presionit dhe tubacioni i ajrit për lidhjen e platformës se përzierëses dhe pjesët për matje.

Fig.8 Kompresori i ajrit të komprimuar **EKOMAK (ITALY – ATLAS COPCO Group)**




Rezervuari i ajrit:	
Vëllimi i rezervuarit:	$V = 500$ [litra]
Materiali i rezervuarit:	çelik
Kompresori: me piston	
Kapaciteti i kompresorit	$Q = 1023$ [l/min]
Fuqia e elektromotorit:	$P_e = 5.5$ [kW]
Numri i rrotullimeve të elektromotorit:	$n_e = 1420$ rr/min

Pompa e aditivit Janë dy (2) peshore të përzierjeve kimike të aditivëve (Pesha 2 x 25 l), me të gjitha komponentët e nevojshme për rritjen e fortësisë së çimentos dhe për aplikim në temperatura të ndryshme.



Të dhënat teknike të pajimeve në linjën teknologjike Në pozicionin **nr. 2** është paraqitur cisternë e cila shërben si deponi e ujit me kapacitet rreth **50000 l**. Kjo rezervë e ujit do të shërbej për përgatitjen e betonit pa ndonjë pengesë, duke pasur parasysh se pusi i cili është shpuar (**rreth 20m**) dhe ka sasi të bollshme për nevojat e kompanisë. Fig (3)

Pusi dhe pompa e ujit me pajisje përcjellëse Pompa e ujit me instalimin paraprak të tubacioneve, përdoret për ta furnizuar sistemin e peshores së ujit dhe ka një dalje për larjen e jashtëm të mikserit që ujin




e merr nga pusi nëntokësor. Thellësia e pusit nga betonarja: 20 [m], pompa zhytse raketë: 2 [kW], vëllimi i rezervuarit: 3000 [litra].

Fig.Pompa per furnizim me uje Fig.Pompa per furnizim me uje **Kabina komanduese e bazës betonit** Kjo kabinë përbëhet nga:

Kabina komanduese e bazës së betonit



Softuerin për menaxhimin e impiantit, kompjuterin personal me monitor 19 ", printerin laserik për listën e materialit të shpenzuar Konstruksioni i kabinës



Do të bëhet me panel me trashësi 5 [cm], Dritare të pleksiglasit, Seti i të gjitha kablllove të nevojshme do të jetë i instaluar së bashku me kuadrin elektronik, Kuadri me tension, kontroleri dhe sistemi i monitorimit të peshoreve.

Gjeneratori i rrymës elektrike me naftë Agregati (gjeneratori) i ka këto karakteristika teknike:



Gjeneratori i rrymës elektrike

Fuqia:	$P_{\text{gjen}} = 250 \text{ [kVA]}$
Tensioni	$U = 230/400 \text{ [V]}$
Frekuenca:	50 [Hz]
Numri i rrotullimeve	$n_{\text{gjen}} = 1500 \text{ [rr/min]}$

Transformatori i furnizimit me rrymë elektrike YZ5 10/04 kV

Trafsformatori YZ5 : 10/0.4 [Kv]	
Trafo elektrike:Tensioni punues:10/0.4 [kV]	
Fuqia:	250 [kVA]



5.Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve të mundshme në mjedis

5.1 Ndikimi në Ajër

Gjatë prodhimit të betonit, ndikimi negativ në mjedis shprehet edhe në ajër. Në zonën e shtrirjes të bazës për prodhimin e betonit ajri është i pastër.

Deri te ndotja vie për shkak të punëve dhe aktivitetit në prodhimin e betonit, ngarkimit dhe transportit. Ndotësit janë kryesisht pluhuri që barten me anë të erës. Por duke iu falënderuar formës së relievit dhe konfiguracionit të terrenit bartja e pluhurit me anë të erës nuk arrinë deri te vendbanimet e banuara më të afërta, pasi ato janë larg nga lokaliteti ku do të prodhohet betonit.

Ndotja e ajrit vjen edhe gjatë lirim të gazrave nga përdorimi i përbërësve për prodhimin e betonit dhe nga automjetet e ngarkimit dhe transportit të cilat si lëndë djegëse përdorin derivatet e naftës. Teknologjia e vendosur për prodhimin e betonit është me standarde të cilat mundësojnë që prodhimi mos të ndikojë apo që mund të rrezikon shëndetin e njeriut.

5.2 Ndikimet në tokë

Ndikim negativ mund të kenë mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë mirëmbajtjes së makinerisë dhe mjeteve të transportit si dhe mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike që shkaktohen nga vet njeriu.

Ndikim të madh negativ mund të kenë edhe derdhja e vajrave lybrifikues të cilat nëse bien në tokë janë të dëmshme për natyrën pasi që edhe koha e dekompozimit të tyre është e madhe. Si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmit punues, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët. Ndikimet nga mbeturinat lëngëta shkaktohen nga derdhja e vajrave

dhe derivateve të ndryshme si dhe nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe punës së tyre.

5.3 Ndikimet në Ujë

Ndikime negative në ujë shkaktohen nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekura më lartë të cilat me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore, të reshurat atmosferike si dhe nga ndotja e ujërave nëntokësore.

Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor. Ndikimet tjera negative janë edhe derdhja e ujërave të zeza, mbeturinat e ndryshme, etj.

5.4.Ndikimi në Peisazh

Lokaliteti ku planifikohet të prodhohet betoni , ka marrë dhe do të merr pamjen e një vendi industrial.Gjatë fazës së prodhimit , peizazhi do të pëson degradim i cili me masat të cilat do të merren në mbarim të punëve prodhuese, këtij lokaliteti do ti kthehet pamja në harmoni me gjendjen e përafërt të rrethinës. Këto masa do të arrihen me aplikimin e rikultivimit si masë për kompensim të shfrytëzimit të pasurive- resurseve natyrore

5.5. Ndikimi në florë dhe faunë

Gjatë fazës së përgatitjes për vendosjen e bazës së betonit në këtë lokalitet si dhe gjatë kohës së prodhimit të betonit , nga proceset teknologjike që do të zhvillohen, për pasojë do të kemi dëmtimin e florës, por e cila duhet të rikultivohet pas mbylljes së punëve prodhuese të betonit. Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht

për arsye se do të largohen nga rajoni i veprimtarisë prodhuese dhe do të zhvillohet në terrenin e përfaqësues që i përshtatet faunës.

5.6 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Në afërsi të lokalitetit ku do të zhvillohen punimet për prodhimin e betonit nuk ka ndonjë objekt banimi prandaj në këtë lokalitet nuk do të ketë zhvendosje të popullatës.

Operatori për prodhimin e betonit në këtë lokalitet do të ketë nevojë për fuqi punëtore shtesë, prandaj do të jetë i detyruar që numrin e punëtorëve ta plotësojë nga popullata vendëse.

Sipas analizave kimike si dhe sistemet e filtrimit që do të përdoren gjatë prodhimit, nuk ka rrezik nga materje të dëmshme për shëndetin e njeriut, pasi që sasia e gazrave të cilat do të lirohen në këtë lokalitet është gati e papërfillshme.

5.7. Zhurma

Zhurma e shkaktuar gjatë operacionit të prodhimit nga pajimet teknologjike të agazhuara në impiant është e karakterit lokal dhe nuk mundë të ketë ndonjë ndikim në zonat e banuara.

Zhurma shkaktohet gjatë kryerjes së aktiviteteve prodhuese, nga makinat që e ngarkojnë lëndën, kamionët transportues etj.

Shfrytëzimi i pajimeve bashkohore për kryerjen e punëve operacionale mundëson që zhurma në hapësirën ku është vendosur baza për prodhimin e betonit nuk do të jetë më e madhe se 90dB (duke patur parasysh distancën e lokaliteteve të banuara rreth 3 km). Sa më e madhe të jetë distanca edhe zhurma do të jetë më e vogël.

Do ta japim në formë tabelare nivelin e zhurmës në raport me distancën

Zhurma	Distanca(m)			
	10	50	100	500
90dB-niveli Për paisje moderne	59	45	39	25

5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Aktiviteti i bazës së betonit, dhe mekanizmi punues do të jetë i mirëmbajtur si dhe nën mbikqyerjen e stafit profesional që punon në kuadër të kësaj kompanie. Pasi në lokalitetin ku prodhohet e betoni dhe seperiimi i rërës e zhavorrit nuk kemi të bëjmë me materie të rrezikshme për mjedisin, atëherë rreziqet e mundshme që mund të ndodhin në vend pune mund të jenë të natyrës së ndryshme gjatë proceseve teknologjike si:

- ❖ Gjatë procesit të mbushjes së silosit me cement
- ❖ Gjatë procesit të mbushjes së autocisternës me ujë.
- ❖ Gjatë proceseve tjera teknologjike në prodhimin e betonit.

6. Ndërmarrja e masave parandaluese në zvoglimin e ndikimeve

6.1 Masat e ndërmarra për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve në ajër të krijuar gjatë realizimit të punëve profesionale, nga mekanizmi për bartjen e lëndës, prodhimit, ngarkimit etj duhet të ndërmerren këto masa:

- ❖ Me rastin e mbushjes së rezervuarve me cement duhet pasur kujdes që të mos ketë ndonjë shkaktar zjarri deri sa bëhet zbrazja e çimentos nga cisternat transportuese në rezervuarët e fiksuar në lokalitetin e Kompanisë.

- ❖ Duhet që në të gjitha pikat kyqe dhe me rrezik të vendosen aparatet kundër zjarrit.
- ❖ Duhet të bëhet spërkatja me ujë e të gjitha sipërfaqeve operacionale , rrugëve të pa asfaltuara nëpër të cilat bëhet edhe transporti i lëndës së prodhuar.
- ❖ Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt teknik i paisjeve teknologjike në mënyrë që gazrat që lirohen nga këto makina të jenë sa më pak të ndotura.
- ❖ Kamionët e transportit të lëndës duhet të mbulohen gjat transportit të lëndës.
- ❖ Kompania duhet që çdo herë ta ketë cisternën e mbushur me ujë dhe të gatshme për punë.

6.2 Masat e ndërmarra për mbrojtjen e tokë

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve në tokë gjat kryerjes së punëve operacionale, në kompani duhet të ndërmerren këto masa:

- ❖ Masa bimore e larguar duhet të deponohet në vende të caktuara që të mos lejohet kalbja e tyre në mënyrë që ato të mund të përdoren më vonë..
- ❖ Për ti parandaluar pasojat e erozionit duhet të bëjmë rikultivimin biologjik në ato pjesë ku është e mundur.
- ❖ Duhet ndërmarrë masa që vajrat e makinave dhe të pajimeve tjera të mos derdhen në tokë.
- ❖ Nëse për shkak të ndonjë avarie në fazën e prodhimit duhet bërë largimi i vajit nga ndonjë makinë, atëherë duhet patur kujdes që vaji të derdhet në ndonjë enë jo ujëlëshuese e cila duhet të vendoset nën makinën e cila riparohet.


- ❖ Të gjitha mbeturinat e ngurta që krijohen në lokalitet gjatë procesit të prodhimit duhet të grumbullohen dhe të klasifikohen sipas llojit: si p.sh. ato metalike të grumbullohen në vende të posaçme e më pastaj ti shiten kompanive të licencuara për ripërpunimin e tyre kurse ato që mbeten për nevojat e Kompanisë të vendosen nëpër kontejner të veçant në mënyrë që të mos jenë shkaktar të ndotjes së ambientit.
- ❖ Mbeturinat e lëngëta që krijohen me rastin e ndrrimit të vajrave nëpër makina duhet të vendosen nëpër kontejner të veçant e më pas tu jepen kompanive të licencuara të cilat merren me riciklimin e tyre.

6.3. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e ujit

- ❖ Mbrojtja e lokalitetit ku prodhohet, nga ndotësit siq është lymi i cili shkaktohet me rastin e të reshurave atmosferike bëhet në atë mënyrë që rreth e përqark hapslrës ku prodhohet hapen kanale, të cilët përveq se do ta mbrojnë bazën e betonitt nga vërshimet, do ti mbrojnë edhe ujërat nga ndotësit eventual siq janë vajrat e ndryshëm që kanë mund me rrjedhë nga makinat transportuese.
- ❖ Prandaj për pastrimin e ujërave gjatë të reshurave duhet të krijohen pusët sedimentuese të cilët do të shërbenin për sedimentimin e materialeve të ngurta si dhe separatori për pastrimin e ujit të ndotur nga rrjedhja eventuale e vajrave motorike. Pastaj ujrërat e pastra lëshohen në risipient.
- ❖ Duhet patur kujdes që pusët sedimentuese dhe separatori të pastrohen rregullisht, poashtu në mihjen sipërfaqësore duhet të ket rregullisht absorbues të vajrave motprike dhe karburanteve.
- ❖ Ujërat e zeza duhet sëpari të trajtohen në gropën septike ku bëhet neutralizimi ndotësve. Gropa duhet të ndërtohet në raport me numrin

e punëtorve që punojnë në kompani. Ajo kohë pas kohe pastrohet nga kompani të licencuara për ti ikur tejmbushjes.

- ❖ Të gjitha këto që u cekën rreth pastrimit të ujërave do ti paraqesim në mënyrë skematike.
- ❖ Skema teknologjike për trajtimin e ujërve



6.4.Masat e ndërmarra për mbrojtje nga zhurma

Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Për analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me ligjet dhe nivelet e lejuara për vendet ku punojnë dhe jetojnë njerëzit.

Në rast se zhurma e mesit ku punohet i tejkalon kufijt normal atëher duhet të merren të gjitha masat e duhura që niveli i zhurmës të bie në kufijt normal sipas rregullave në fuqi. Të punësuarit në kompani, varësisht nga vendi i punës duhet të përdorin edhe mjetet mbrojtëse nga zhurma.

6.5 Masat e marrura për mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore

Masat e mbrojtjes së botës bimore lidhen ngusht me ruajtjen e tokave në pjesët e ngastrave të shfrytëzueshme, këto toka duhet të ruhen nga erozioni i mundshëm.

Kompania duhet që të ket kujdes gjatë deponimit të mbeturinave që ato të deponohen në vende të caktuara.

Në rast të lajmërimit të zjarrit duhet të merren masa për neutralizimin e tijë, kurse paisjet kundër zjarrit duhet të kontrollohen rregullisht dhe të ruhen në mënyrë të veçant.

Kurse sa i përket botës bimore kompania duhet patur kujdesë që ti kufizoj lëvizjet e puntorve sa të jet e mundur jashta kufinjëve fushës operationale, poashtu të kontrolloj zhurmën e shkaktuar si dhe ti kushtoj kujdes ndotjes së ajrit

6.6 Mast e marrura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale

Për evitimin e rreziqeve nga aksidentet gjat prodhimit të betonit dhe seperimit të rërës e zhavorrit duhet:

- ❖ Duhet të bëhet plani i intervenimit në raste të aksidenteve ekologjike.
- ❖ Duhet patur kemikate që neutralizojnë derivatet dhe vajrat lybrifikues.
- ❖ Duhet të bëhet plani i mbrojtjes nga zjarri.
- ❖ Duhet që lokaliteti i fabrikës të jet i thurur.
- ❖ Të merren të gjitha masat e sigurisë në përputhje me ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punëtorëve dhe mjedisit në punë.

7. Programi i monitorimit

- ❖ Për monitorimin e ndikimeve direkte të aktiviteteve prodhuese, të proqeseve teknologjike, duke u bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis të cilat janë ndikimi në tokë, në ajër dhe ujë të cilat do të ishin minimale pas marrjes së masve për zvogëlimin e këtyre ndikimeve.
- ❖ Për këtë arsye parashihet një program monitorues për prodhimin e betonit. Monitorimi i ajrit, ujit dhe zhurmës duhet të bëhet me marrjen mostrave dhe

kryerjen e analizave në institute adekuate dhe të raportohen në ministri të mjedisit dhe planifikimit hapsinorë sipas kërkesës së tyre.

8 Raportimi

- ❖ Do të kryhet nga udhëheqja dhe ekspertët e Kompanisë së bashku në fundë të qdo viti kalendarik, ku do të paraqiten të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat do të raportohen te autoritetet përkatëse në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë dhe komunitetin lokal të komunës.

9. Ndërmarrja e masave rehabilituese pas përfundimit të aktiviteteve prodhuese

9.1. Objektivat e rikultivimit

Rikultivimi i hapësirës ku është prodhuar betoni, duhet të trajtohet në përputhje me kërkesat bashkohore të mbrojtjes dhe rikultivimit të mjedisit, të cilin duhet pa si një prioritet të rëndësishëm edhe në këtë lokalitet ku zhvillohet aktiviteti prodhues. Nga proqeset teknologjike për prodhimin e betonit do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th substrate të pa përshtatshme për rikultivim. Substratet me përbërës të rërës , që pa tjetër duhet ti nënshtrohen rehabilitimit gjerë në masën e përmirësimit të pjesërishëmtë vetive të tyre dhe krijimit ose zëvendësimit të tijë me ate të rrethinës ashtu që të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivimin bujqësorë dhe ate malorë. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshinë revitalizimin në tërsi të hapësirave të shfrytëzuara dhe dëmtuara nga punimet prodhuese.

Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga:

Qëllimi i rikultivimit- i cili ndikon që pas përfundimit të punimeve operacionale, sipërfaqeve të degraduara prapë tu kthehet funksioni i tyre primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvoglohet ndikimi negativ i këtijë projekti në ekosistem. Planifikimi i shfrytëzimit të tokës-planifikohet që toka në lokalitetet e mihjes të rikultivohet duke iu përshtatur gjendjes së përafërt me atë të rrethit. Rikultivimi është i lidhur me aktivitetet prodhuese, përkatësisht përfundimin e punëve dhe shpalljen e mihjes sipërfaqësore të mbyllur. Të gjitha aktivitetet e lartëshënuara synojnë objektivat e rikultivimit që kanë këto qëllime:

- ❖ Prodhimin e biomasës
- ❖ Rehabilitimin e peisazhit dhe kthimin e pamjes vizuele në harmoni me formën reliefore të terrenit.
- ❖ Kthimin e profilit pedologjik të tokës së degraduar me rastin e punimeve operacionale.
- ❖ Zgjerimi i kapacitetit filtrues natyror të ajrit.
- ❖ Mveshja i sipërfaqeve gjveshura si pasojë e punimeve operacionale.
- ❖ Krijimin e një pejsazhi të bukur, të përafërt me atë të natyrës për rreth.

9.2 Struktura përfundimtare e sipërfaqeve

Struktura përfundimtare e sipërfaqes për rikultivim është e paraqitur në planin e rikultivimit. Pas përfundimit të punimeve operacionale, me rikultivim teknik do të krijohet një profil i ri i tokës i sili mundë të përdoret edhe për nevoja tjera . Propozohet që rikultivimi të bëhet me mjelljen e barit dhe bimëve tjera të

ndryshme dekorative përfshirë këtu edhe drunjë të ndryshëm dekorativ në ngastrën ku bëhet prodhimi. Për të qenë rikultivimi sa më i suksesshëm duhet të kryhen këto faza të procesit të rikultivimit. Rikultivimi teknik, Rikultivimi agroteknik dhe rikultivimi biologjik.

9.3. Rikultivimi Teknik

Në bazë të ligjeve relevante të mjedisit çdo tokë e dëmtuar si shkas i aktiviteteve prodhuese, pas skadimit të afatit të shfrytëzimit ekonomik të sipërfaqes, investitori është i që tokës ti kthej pamjen e më parshme. Në bazë të punimeve të kryera hartografike- pedologjike në lokalitetin e fabrikës duhet konstatuar se cilat pjesë iu janë nënshtruar dëmtimeve nga aktivitetet prodhuese, për këtë arsye duhet studiuar llojet e dëmtimeve si dhe intenzitetin dhe ndikimin e tyre në botën bimore e pastaj të shqyrtohen mundësitë e sanimit të efekteve të pa volitshme si dhe rikultivimin e kësaj pjese. Gjatë rikultivimit teknik duhet të përvetësohet teknologjia e tillë që rikultivimi të kryhet njëkohësisht gjatë punimeve në minierë pra me teknologji mih- transporto- palos. Me krijimin e sipërfaqes së lirë nga sheshet punueseduhet të fillohet me dizajnimin teknik të hapsirës së lirë duke bërë përgatitjen e terrenit për rikultivim. Pas përfundimit të aktiviteteve punuese hapsira do të marrë formën e degraduar dhe ndryshuar me peisazhin ekzistues, e cila me rastin e rikultivimit zonës i jep një pamje natyrore. Pas përfundimit të punimeve minerare fillon rikultivimi teknik i sipërfaqeve tokësore të degraduara. Degradimi i sipërfaqeve gjatë punimeve prodhuese shkon deri në atë masë sa bëhet zhdukja fizike e profilit pedologjik të tokës, prandaj në këtë fazë të rikultivimit propozojmë krijimin e profilit pedologjik të tokës në sipërfaqet e dëmtuara. Për formimin e shtresës së sipërme sipërfaqësore produktive të tokës parashihet mihja selektive e humusit dhe vendosja direkte në sipërfaqet punuese ku janë kryer punimet d.m.

th. Duhet të përvetësohet teknologjia e tillë ë rikultivimi teknik të kryhet njëkohësisht gjat zhvillimit të punimeve në bazë. Pra me përfundimin e shfrytëzimit të lokalitetit nga punimet operacionale , fillon shtresimi i dheut dhe humusit në këto hapsira. Nëse konstatojmë se shterpa nuk i plotëson kërkesat kualitative për rikultivim kem cekë edhe më parë, duhet të konsultohen ekspertët profesional të lëmisë së agronomisë dhe të sillet sasia e dheut nga një vend tjetër me qëllim të suksesit të rikultivimit.

9.4. Rikultivimi agroteknik

Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e rikultivimit agroteknik e cila fazë starton me analizimin e substratit të krijuar, për të përcaktuar vetitë agrokimike dhe pedologjike. Në bazë të analizave të propozohen masat meliorative dhe agroteknike që do të aplikohen në këtë tokë të re.

Toka është njëri prej elementeve të këtijë mjedisi të cilës përveq që i ndërrohet destinimi primar, pëson degradim të rëndë, deri në zhdukjen e profilit pedologjik të sajë. Kjo paraqet formën më të rëndë të dëmtimit të tokave. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një masiv të fortë e cila është e mbuluar me tokë të cektë.

Për të llogaritur numrin e fidaneve për tërë sipërfaqen që do të rikultivohet duhet të kalkulohet me distancën në mes të rendeve dhe distancën në rend.

$$N_f = S/axb$$

S- paraqet sipërfaqen, a- distanca në mes rendeve b- distanca në mes fidaneve. Në rastin tonë propozojmë që të dy këto distanca të jenë nga 2m. Në pjesët ku do të bëhet mbjellja e bimëve duhet të vendoset një shtresë e humusit prej 0.5 m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e këtijë substrati me qëllim që të jetë shtresë më kompakte.

Në këtë lokacion kemi të bëjmë me një reliev të rrafshët i cili për tu përshtatur me rrethinën preferohet që të mbushet me një shtresë dheu(50 cm) aluviale e cila do të mundësonte përdorimin e kësaj sipërfaqeje në harmoni me tokat që e rrethojnë.

9.5. Rikultivimi Biologjik

Qëllimi afatgjatë i rikultivimit biologjik është që të krijojmë ekosistem të ri në hapësirat e shfrytëzuara dhe të dëmtuara në të cilën do të krijohet baraspeshë relative e të gjitha elementeve të ekosistemit siqë janë : Toka, flora e fauna dhe efekti ekonomik në prodhimtarin bujqësore, blegtorale dhe në silvikulturë. Rikultivimi biologjik është faza përfundimtare me të cilën arrihet edhe qëllimi i rikultivimit. Bimët të cilat i kemi propozuar në këtë projekt (kryesisht bari i parkut dhe bimë tjera dekorative) apo përshtatja e këtyre sipërfaqeve me rrethinën, duhet tu përshtaten kushteve klimatike dhe se me zhvillimin e tyre i japin një pamje të bukur peisazhit. Këto bimë adaptohen lehtë dhe janë rezistuese ndaj dëmtuesve biologjik. Edhe pse janë propozuar këto bimë , duhet të bëhet konsultimi me ekspertët profesional të lëmisë së agronomisë dhe me autoritetin e ministrisë së bujqësisë dhe pylltarisë.

10. Monitorimi pas shfrytëzimit

Pas përfundimit të punimeve në prodhimin e , pushon edhe elementi i pluhurit dhe i ndikimeve tjera në mjedis. Prandaj nuk paraqitet nevoja për monitorimin e këtyre ndikimeve.

Por kompania “PRO & CO GROUP” ka për detyrë të bëjë monitorimin e sipërfaqeve të rikultivuara, për një kohë të caktuar.

11. konkluzion

Prodhimi i betonit, në këtë bazë nuk e tejkalon nivelin e vlerave të rekomanduara nga ligji për mbrojtjen në mjedis, ligjet dhe aktet tjera nënligjore për mjedis.

Ndikimet në tokë, ujë, ajër duhet që rregullisht të kontrollohen. Këto ndikime do të monitorohen dhe do të raportohen në fund të çdo viti kalendarik.

Pas punimit të këtijë raporti, mundë të konkludohet se prodhimi i betonit në këtë lokacion nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerzve,gjithashtu ndikimet në tokë,ujë , ajër ,peisazh dhe pamje vizuele. Pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport konstatojmë se mundë të minimizohet në nivel të lakmueshëm, ose edhe të eliminohen në fazën e rehabilitimit të hasirave të degraduara gjat prodhimit të betonit. Gjithashtu është e paraparë që paralel me prodhimin e betonit, të bëhet të bëhet edhe rikultivimi i sipërfaqeve të shfrytëzuara aty ku lejojnë mundësit e operacioneve teknologjike të prodhimit të betonit. Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme dhe i mundësojnë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë dhënien e mendimit për Pëlqimin Mjedisorë sipas kërkesës së Kenan Einit pronar i Kompanisë “PRO & CO GROUP” sh.p.k. Viti.